

KONTRATË PËR SHITJEN E PJESEVE TE KAPITALIT

Sot me date 17/02/2025 , ne Tirane, shtetasit e meposhtem u ulen dhe redaktuan kete kontrate shitje kuotash.

PALET NE KONTRATE

1. **Mustafa Ömeroğlu** ,shtetas turk, i datëlindjes 26/05/1982 lindur në Turqi dhe banues në Durres madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr Pashaporte 27754560994.(me poshte referuar si "Shitesi")

Dhe

2. **Özkan Kiper**, shtetas turk, i datëlindjes 01/01/1990 lindur në Turqi dhe banues në Durres , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr Pashaporte 33922347632. (me poshte referuar si "Blerësi"),

te dyja palet me aftesi te plote per te vepruar, me vullnet te lire, duke iu permbajtur dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, pranojne te lidhin dhe ne fakt lidhin kete Kontrate per Shitjen e Pjesëve sipas kushteve te meposhtme.

Kushtet paraprake

Shitesi eshte pronar i 1 kuote me vlere nominale 100,000 Leke qe perfaqeson 50% te kapitalit themeltar te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur "Babil", me seli ne **DURRES, Rruga K.Kazanxhi, Lagja nr.16 Zona kadastrale 8513, pasuria 2/355, volumi 31, Durrës**

Pala shitesë deklaron se kuotat e shoqerise "Babil SHPK" jane plotesisht te lira nga çdo lloji barre e sekuestroje apo pengu.

Pala shitesë deklaron se ka marre prej pales blerese çmimin e shitjes per 100.000 lekë pra 50% të kuotave si me sipër dhe pagesa parashikohet ne nenin 2 ,pika 2.2.

Bleresi deshiron te bleje dhe Shitesi deshiron te shese 50% te kapitalit te Shoqerise me vlere 100.000 Leke te zoteruar nga Shitesi, sipas kushteve dhe afateve te



meposhtme;

Bleresi ka analizuar, verifikuar dhe miratuar gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile te Shoqerise ne momentin e lidhjes se kesaj kontrate.

Meqë ekzistojnë këto kushte paraprake, palet bien dakort per sa me poshte vijon:

Neni 1 - Kushtet Paraprake

Kushtet paraprake te siperpermendura jane pjese perberese e kesaj Kontrate.

Neni 2 - Blerja e pjeseve te kapitalit

2.1. Shitesi merr persiper t'i shese dhe transferoje Bleresit, dhe Bleresi merr persiper te bleje, 50% te kapitalit themeltar te Shoqerise te zoteruar nga Shitesi, teresisht te lira nga çfaredo lloj detyrimi ne favor te te treteve, dhe me nje cmim te barabarte me vleren e tyre nominale 100.000 Lekë.

2.2. Pagimi i çmimit u be me para ne dore nga ana e Bleresit ne vlere 100.000 Leke, ne momentin e firmosjes se kontrates.

Pronesia i kalon pales blerese ne momentin e neneshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 3 - Detyrime dhe garanci

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe ne çfaredolloy momenti tjeter te metejshe pas lidhjes se saj, Shitesi do t'i garantoje Bleresit, prane selise se Shoqerise, akses ne origjinalet e librave kontabel te Shoqerise dhe cdo dokument tjeter, prone ose sende qe aktualisht jane ne pronesi te Shoqerise, ose qe duhet me pas te behen te Shoqerise.

Neni 4 - Korrespondenca

4.1. Te gjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera ndermjet paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorezohen prane selise se Shoqerise, dhe prane selise se Bleresit.

4.2. Tegjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera do te dergohen me ane te letres rekomande ose me faks.



4.3. Çdo informacion, kerkese ose njoftim do te jete i vlefshem vetem nese ekzistojne kushtet e meposhtme: a) nese eshte derguar me faks, ne momentin ne te cillin eshte marre faksi; b) nese eshte derguar me leter rekomande, ne daten e dorezimit tek marresi qe do te vertetohet me fleten e kthimit.

Neni 5 - Shpenzime dhe taksa

Shpenzimet legale dhe kontabile, ashtu si edhe çfaredo shpenzimi tjeter qe lidhet me kete kontrate, si edhe shpenzimet per transaksione te perfshira ne to, do te jene ne ngarkim te pales qe i mbulon.

Neni 6 - Trashegimia dhe cedimi

Kjo kontrate do te detyroje palet dhe do te jete e vlefshme midis tyre, ashtu edhe per trashegimtarete e tyre. Ne cdo rast, asnjera nga palet nuk mundet te kaloje te treteve kontraten pa miratimin me shkrim te pales tjeter.

Neni 7 - Permbajtja e kontrates dhe ndryshimet

Kjo kontrate perfshin teresisht marredheniet midis paleve dhe zevendeson te gjitha marreveshjet e meparshme qe jane te lidhura me kete objekt. Ndryshime te mundshme ose kufizimet e kesaj kontrate mund te behen vetem me shkrim, te nenshkruara nga te gjitha palet dhe t'i bashkengjiten asaj.

Neni 8 - Origjinalet

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) origjinale, ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkruara nga palet ne daten ..17/02/2025...

Neni 9 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur, mosmarreveshja do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor TIRANE.

Neni 10 - E drejta e zbatueshme

Kjo kontrate dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te disiplinoohen e ushtrohen ne baze te se drejtes shqiptare.

Neni 11 - Vlefshmeria

Kjo kontrate behet e vlefshme me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet.

Kjo kontrate nenshkruhet nga te dyja palet ne Tirane, me date 17/02/2025.

* * *

Palet pasi lexojne aktin e mesiperm dhe e gjejne ate konform vullnetit te tyre te lire , e nenshkruajne ate ne prezencen e tyre.

Mustafa Ömeroğlu

Mustafa Ömeroğlu



Özkan Kiper

Özkan Kiper

